

Një raport tjetër i KE-së: prizëm i ri, dhimbje të vjetra

Analizë e shkurtër e raportit të KE-së për Maqedoninë e Veriut 2022

Temat kryesore të prezantimit të paketës së zgjerimit në Komisionin e Politikës së Jashtme nga Komisioneri Varheji ishin statusi kandidat i kushtëzuar i Bosnje-Hercegovinës, konferencat ndërqeveritare për fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, si dhe ngecja në Serbi në lidhje me politikën e jashtme të përbashkët, së bashku me ndikimin e pushtimit rus të Ukrainës.

Ndryshe nga viti i kaluar, Komisioni Evropian këtë vit mundi të paraqesë mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare me Shqipërinë dhe konferencën e parë politike ndërqeveritare me Maqedoninë e Veriut si suksesin kryesor në politikën ndaj Ballkanit Perëndimor, madje edhe si një "moment historik", që shënon "një fazë të re të politikës së zgjerimit".

Ky është pikërisht prizmi i ri që i jep një ton tjetër Raportit të sivjetshëm për Maqedoninë, i cili nga ana tjetër ruan strukturën e vitit të kaluar, një pjesë të madhe të përmbajtjes dhe përsërit një numër të madh problemesh kronike.

Nga ana tjetër, analiza e vlerësimeve të Komisionit¹ çon në dy përfundime:

- Vlerësimi i gatishmërisë kryesisht të moderuar në shumicën e grupeve është i njëjtë me vitin e kaluar. Dallime të mëdha mbeten midis kapitujve dhe të njëjtat vlerësime të gatishmërisë nëpër kapituj, me përjashtim të Kapitullit 31 të Politikës së Përbashkët të Sigurisë së Jashtme, ku niveli i gatishmërisë është ngritur në "mirë", falë respektimit të plotë të sanksioneve kundër Rusisë.
- Vlerësimet e progresit janë disi më të mira në krahasim me vitin e kaluar, kështu që në vend të mungesës së progresit ose përparimit "të kufizuar", Komisioni vëren "progres të caktuar" në shumicën e kapitujve. Megjithatë, kjo nuk sjell ndryshim tek vlerësimi i gatishmërisë, i cili, me përjashtimin e vetëm, ka qenë i njëjtë që nga viti 2019, me shumë pak ndryshime në vitet para.²

1 Rezultati i gatishmërisë pasqyron gatishmërinë aktuale për sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të përgjithshme që duhet të ndërmerren me anëtarësimin në BE, ndërsa rezultati i progresit është në raport me raportin e vitit të kaluar.

2 Bashkëngjitur do të gjeni një përmbledhje të rezultateve sasore të gatishmërisë dhe progresit.

Nga këtu, konkluzioni ynë nga viti i kaluar mbetet se ky është rezultat i natyrës afatgjatë të procesit të anëtarësimit, ndryshimit të vazhdueshëm të legjislacionit evropian, por edhe mungesës së përgjithshme të mbështetjes politike në BE për procesin e zgjerimit, vizavi retorikës së ndryshuar të këtij viti. Ruajtja e kësaj qasjeje nuk jep një shtysë për reforma nga perspektiva e një shteti kandidat.

GRUPI 1: THEMELET

Siç pritej, vëmendja më e madhe në Raport i kushtohet [Grupi 1: Themelet](#).

Për [institucionet demokratike](#), është thelbësore që Maqedonia e Veriut të vazhdojë përpjekjet e saj për të forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, “pavarësisht sfidave të caktuara”. Vlerësimi i vitit të kaluar u përsërit ku thuhet se shteti tregoi një “angazhim për të dhënë rezultate” në zonat kyçe të grupit Themelet. Këtë vit, raporti vlerëson progresin në reformat zgjedhore dhe e cilëson atë si të kufizuar. Fjalori që KE përdor në raport me Parlamentin është më i rreptë se vitin e kaluar. Ndryshe nga viti i kaluar, kur funksionimi i Parlamentit u vlerësua përkundër polarizimit politik, këtë vit ai në masë të madhe është subjekt i kritikave.

Ashtu si vitin e kaluar, ajo mirëpret gjithashtu njohjen e [shoqërisë civile](#) si palë kryesore e interesit nga institucionet shtetërore, duke theksuar vetëm bojkotin e vazhdueshëm të Këshillit për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile.

Sa i përket reformës në [administratën publike](#), vlerësimi i gatishmërisë edhe në këtë raport mbetet i njëjtë si në atë të fundit - i moderuar, por ka progres të kufizuar në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar. Rekomandimet kryesore për ndryshimin e ligjeve sistematike relativisht të reja të miratuara me mbështetjen e KE-së dhe miratimin e ligjeve të reja përsëriten, në krahasim me rekomandimin për t’u fokusuar në zbatimin.

Për sa i përket institucioneve demokratike në përgjithësi, u përsëritën paralajmërimet për shumicën e “vështirësive” të vjetra, si p.sh., nevoja për reforma zgjedhore në kohë para zgjedhjeve, një numër i madh ligjesh me procedura të shkurtuara, iniciativa të reja sporadike në vend të zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues, si dhe procesi i ndërprerë i reformës së vetëqeverisjes lokale. Këtë vit u shtua edhe këshilla për Kuvendin që emërimet të mos bëhen në bazë politike, por në bazë të meritës, që është arsyeja e pamundësisë së zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe zyrtarëve të tjerë të zgjedhur nga Kuvendi.

Vlerësimi i ri në raportin e këtij viti është vlerësimi se [gjyqësori](#) ka demonstruar një “angazhim për mbrojtjen e integritetit dhe pavarësisë së tij”, por zvogëlimi ndjeshëm i përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, për shkak të daljes në pension dhe përzgjedhjes së parakohshme të rinjve, tashmë është shqetësuese. U përsërit paralajmërimi se Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë mbetet e vetmja “hyrje” për këto profesione dhe se trajnimi fillestar nuk duhet të tentohet. Pavarësisht nga efikasiteti i ruajturi i gjyqësorit, kritikata e përsëritura për dygjuhësinë në procedurat gjyqësore dhe pagat në gjyqësor kanë qenë të mprehta.

Situata në fushën e **të drejtave themelore** është sërish shqetësuese për sa i përket zbatimit. Problemet kronike që vazhdojnë në fusha të caktuara përsëriten, si **gjendja dramatike** në burgje dhe zbatimi i pamjaftueshëm i rekomandimeve të Komitetit kundër Torturës. Progresi është i kufizuar për sa i përket lirisë së shprehjes, të cilës KE-ja i kushton gjithnjë e më shumë vëmendje çdo vit, duke përsëritur dobësitë e vjetra, por edhe duke konstatuar rreziqe të reja, siç është rifutja e reklamave të paguara nga qeveria.

Në **luftën kundër korrupsionit** raporti është fokusura në paraqitjen e rezultateve të rasteve, veçanërisht atyre të profilit të lartë, me konstatim pozitiv për vazhdimin e rasteve nga ish-PSP-ja. Komisioni përsërit vlerësimet pozitive të Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit. Në rekomandimet kyçe, ndryshe nga viti i kaluar, përparësi i jepet ndër të tjera zbatimit efektiv të rekomandimeve të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO). Komisioni vetëm konstaton suspendimin e kreut të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit, pa hyrë në shpjegim apo vlerësim të mosmarrëveshjes ndërmjet kësaj prokurorie dhe Policisë Financiare - temë kjo që ka trazuar opinionin publik në vend vitin e kaluar.

Lidhur me **Kapitullin 24 Drejtësia, Liria dhe Siguria**, katër raportet e fundit tregojnë të njëjtin ritëm progresi dhe të njëjtin nivel gatishmërie - të moderuar. Progres është shënuar në zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për të luftuar terrorizmin, miratimin e dokumenteve strategjike në fushën e menaxhimit të kufirit dhe migracionit, përmirësimin e kapaciteteve për hetime financiare, bashkëpunimin policor ndërkombëtar dhe bashkëpunimin me EUROJUST, luftën kundër trafikut të drogës. Ndër dhimbjet e vjetra përsëriten mungesa e kapaciteteve të qendrave hetimore, mangësitë në sistemin e migracionit, procedurat e azilit, si dhe kapaciteti i kufizuar i Observatorit Kombëtar të Drogës. KE paralajmëron nënshkrimin e kontratës së shumëpritur me Frontex deri në fund të vitit.

Në mesin e **kritereve ekonomike** në raport me ekonominë e tregut, vihet re stabilizim i borxhit publik dhe reduktim i deficitit buxhetor, si rezultat i rimëkëmbjes së ekonomisë, por edhe të të ardhurave tatimore të rikuperuara pas shokut që shkaktoi pandemia. KE përshëndet miratimin e Ligjit për buxhete, miratimi i të cilit është vonuar për më shumë se dy vjet, por theksohet se miratimi i ligjit për partneritet publiko-privat është vonuar. Vlerësohet se nuk ka përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e mjedisit të biznesit. Për sa i përket kriterit të dytë (aftësia për t'u përballur me presionin e konkurrencës), ndërsa konstatohet "progres i caktuar", analiza nuk lë një përshtypje të tillë. Vihet re se programet arsimore nuk korrespondojnë me tregun e punës, dhe reformat po zhvillohen me ritme të ngadalta, ndërkohë që mungojnë burimet financiare dhe kapacitetet për të mbështetur reformat. Investimet janë nën nivelin e nevojshëm për të përmirësuar lidhjen, duke përfshirë rrjetin e dobët të transportit rajonal. Në vitin raportues është vërejtur rritje e numrit të ndërmarrjeve, si dhe diversifikim i ekonomisë.

Të tre kapitujt që i përkasin grupit Themelet mbeten me vlerësim "avancim mesatar", dhe i vetmi progres i mirë nga viti i kaluar është vërejtur sërish në Kapitullin e Statistikave, që është për shkak të vlerësimit pozitiv të përgatitjes dhe zbatimit të Regjistrimit. Dy kapitujt e tjerë – Prokurimi Publik dhe Kontrolli Financiar, shënojnë progres të kufizuar, me dobësi dhe rekomandime të përsëritura.

GRUPI 2: TREGU I BRENDSHËM

Në grupin 2: Tregu i Brendshëm, ndryshim pozitiv në aspektin e progresit vërehet në pesë kapituj, dhe theksohet dukshëm në kapitujt 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit, 6 - Ligji i shoqërive tregtare dhe 9 Shërbimet financiare. Progresi në këta kapituj është për shkak të harmonizimit të pjesëve të legjislacionit vendas me acquis të BE-së në fusha specifike dhe rekomandohet zbatimi i tyre gjatë vitit të ardhshëm. Stagnimi i vazhdueshëm në kapitullin e rëndësishëm 8, Politika e Konkurrencës, për shkak të kapaciteteve të dobëta të Agjencisë, si dhe në kapitullin 2 Lëvizja e lirë e punëtorëve, ku vihet re se nuk janë ndërmarrë hapa për të siguruar trajtim të barabartë në aksesin në tregun e punës në bazë të përkatësisë etnike. KE, në vlerësimin e saj, e lidh këtë grup me detyrimet e anëtarësimit në tregun e përbashkët të BE-së, por edhe në tregun e përbashkët rajonal.

GRUPI 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA GJITHËPËRFSHIRËSE

Në grupin 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse ndryshe nga viti i kaluar, progresi mund të shihet në të gjithë kapitujt. Krahas miratimit të ligjeve të rëndësishme, si Ligji i Buxhetit, u vlerësuan pozitivisht përmirësimi i mbrojtjes sociale, rritja e financimit të projekteve inovative dhe rritja e buxhetit për arsimin. Politika doganore është një pikë e fortë dhe raporti i KE-së e konfirmon këtë. Vërejtja e vetme në këtë kapitull ka të bëjë me mosratifikimin e Protokollit për tregtinë e paligjshme të produkteve të duhanit. Megjithatë, niveli i gatishmërisë nuk është i avancuar në asnjë kapitull. Rekomandimi i qartë i KE „për të zhvilluar masa të tjera për të rritur konkurrencën e kompanive vendase dhe integrimin e tyre në zinxhirët globalë të vlerës, përveç ndihmës shtetërore“, duket i rëndësishëm.

GRUPI 4: AXHENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME

Në grupin 4: Axhenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme, Kapitulli 27: Mjedisi shënon progres „të caktuar“ ndryshe nga vitet e kaluara të stagnimit apo progresit krejtësisht të kufizuar, por vërejtjet mbeten për zbatimin. Kapitujt e tjerë (14. Politika e transportit 15. Energjia 21. Rrjetet trans-evropiane) kanë shënuar përparim të kufizuar. Shqetësimi i veçantë buron nga fakti se këta kapituj janë një pjesë e rëndësishme e Planit ekonomik dhe investimeve për Ballkanin Perëndimor. Përveç kësaj, paralajmërimet në kapitullin Energjia janë gjithashtu shqetësuese, veçanërisht se është e nevojshme të përshejtohet kalimi në burimet e rinovueshme të energjisë dhe të zvogëlohet varësia nga gazi, si dhe kritikrat për moszbatimin e legjislacionit dhe efijencës së energjisë dhe incentivat e pamjaftueshme.

GRUPI 5: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI

Në **grupi 5: Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni**, nga njëra anë janë kapitur në të cilët shohim progres të vazhdueshëm si kapitulli 12: Siguria e ushqimit, në krahasim me stagnimin si kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore, si dhe kapitulli 32: Dispozitat financiare dhe buxhetore, ndërsa Kapitulli 12. Bujqësia po ecën ngadalë me "progres të caktuar". Konstatimet e vazhdueshme për zvogëlimin e kapaciteteve për shfrytëzimin e fondeve të BE-së dhe vonesat në zbatimin e projekteve më të rëndësishme janë jashtëzakonisht shqetësuese. Kjo kritikë e qartë vjen kundrejt shumicës së deklaratave publike të zyrtarëve qeveritarë për rritjen e kapaciteteve IPA.

GRUPI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME

Grupi 6: Marrëdhëniet e jashtme kanë parë përparim për shkak të rritjes së përputhshmërisë me qëndrimet e BE-së (100 %) dhe pjesëmarrjes sonë në misionet e BE-së. Kapitulli 31. Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë është kapitulli i vetëm në të cilin Komisioni përcakton një ndryshim në nivelin e gatishmërisë për të ndërmarrë detyrimet e anëtarësimit. Megjithatë, mungon një kuadër politik për zhvillimin dhe ndihmën humanitare.

Në këtë raport vërehet mosrespektimi i procedurave të përcaktuara të MSA-së lidhur me detyrimin për të informuar dhe argumentuar kufizimet e futura të importit, gjë që përbën një kritikë serioze për një vend me përvojën më të gjatë në zbatimin e Marrëveshjes.

MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË DHE BASHKËPUNIMIT RAJONAL

Komisioni mban një qasje të kujdesshme ndaj **marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal**, kryesisht duke regjistruar aktivitetet dhe angazhimin për të zbatuar si Marrëveshjen e Prespës ashtu edhe Marrëveshjen me Bullgarinë "në mirëbesim nga të gjitha anët". Njëkohësisht, sa i përket marrëdhënieve dypalëshe me Bullgarinë, u vlerësua se "fokusi ishte në tejkalimin e çështjeve të hapura dypalëshe, të cilat i hapën rrugë fillimit të procesit të anëtarësimit në BE", njëkohësisht duke theksuar se ato janë intensifikuar.

Ndonëse nga teksti i Raportit shihet qartë se Komisioni po përpaket të mbajë një qëndrim të paanshëm, theksohen detyrimet që Qeveria ka marrë përmes negociatave dypalëshe me Bullgarinë, të miratuara më pas në dokumentet e Këshillit të BE-së. Kështu, si në Strategji ashtu edhe në Raport thuhet se "Parlamenti dhe Qeveria janë zotuar të iniciojnë dhe zbatojnë me prioritet ndryshimet kushtetuese përkatëse, për të përfshirë në Kushtetutë qytetarët që jetojnë brenda kufijve të shtetit". Krahas kësaj, raporti përmend edhe nënshkrimin e protokollit të mbledhjes së Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar të krijuar me nenin 12 të Traktatit të Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit, i cili ishte objekt debati të ashpër gjatë diskutimeve për propozimin francez.³

Në kuadrin e lirisë së asociimit, Komisioni i referohet protestave kundër propozimit francez, të cilat i cilëson si protesta «kundër propozimeve të krijuara për të hequr pengesat për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE», duke dhënë një vlerësim të numrit të pjesëmarrësve, dhe duke vlerësuar se herë pas here janë kthyer në përplasje mes protestuesve dhe policisë. Në këtë rubrikë janë zhvendosur edhe informacionet për reagimet për hapjen e klubit bullgar në Manastir, pa përmendur emrin.

3 „U nënshkrua një protokoll dypalësh e mbledhjen e Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar të krijuar nga neni 12 i Traktatit të Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit.» Raport, f. 67.

ANEKS 1: NIVELI I KONSOLIDIMIT DHE PËRPARIMIT⁴

GRUPI	SFERA/KAPITULLI	GATISHMËRI						PËRPARIM		
		2015	2016	2018	2019	2020	2021	2022	2020-2021	2021-2022
1. THEMELET	FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMAT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE	/	/	/	/	/	/	/	/	/
	• REFORMA NË ADMINSITRATËN PUBLIKE	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	23. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE	2	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	1	2
	• FUNKSIONIMI I GJYQËSORIT	2	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	1	2
	• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT	2	2	2	2	2.5	2.5	2.5	1	2
	• LIRIA E SHPREHJES	2	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	0.5	1
	24. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	3	3	3	3	3	3	3	1	2
	• LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR	2	2	2	2	2	2	2	1	2
	LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR	4	4	4	4	4	4	4	1	2
	AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR PRESIONIN KONKURRUES DHE FORCAT E TREGUT NË BE	3	3	3	3	3	3	3	1	2
	5. PROKURIME PUBLIKE	3	3	3	3	3	3	3	1	1
18. STATISTIKË	3	3	3	3	3	3	3	2	3	
32. KONTROLLI FINANSIAR	3	3	3	3	3	3	3	1	1	
2. TREGU I MBRENDSHËM	1. QARKULLIMI I LIRË I MALLËRAVE	3	3	3	3	3	3	3	0.5	0
	2. LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE	1	1	1	1	1	1	1	0	0
	3. E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE	3	3	3	3	3	3	3	0	1
	4. LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT	3	3	3	3	3	3	3	1	3
	6. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE	4	4	4	4	4	4	4	1	2
	7. E DREJTA E PRONËS INTELEKTUALE	3	3	3	3	3	3	3	1	0
	8. POLITIKA E KONKURENCËS	3	3	3	3	3	3	3	0	0
	9. SHËRBIMET FINANSIARE	3	3	3	3	3	3	3	0.5	2
	28. MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE	3	3	3	3	3	3	3	0	1
	3. KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE	10. SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIAT	4	4	3	3	3	3	3	0.5
16. TATIMET		3	3	3	3	3	3	3	1	2
17. POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE		3	3	3	3	3	3	3	1	3
19. POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI		3	3	3	3	3	3	3	1	2
20. NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE		3	3	3	3	3	3	3	1	2
25. SHKENCA DHE HULUMTIMI		4	4	4	4	4	4	4	0.5	2
26. ARSIMI DHE KULTURA		3	3	3	3	3	3	3	0.5	1
29. BASHKIMI DOGANOR		4	4	4	4	4	4	4	2	2
4. AGJENDA E GJELBËR DHE QËNDRUESHMËRIA	14. POLITIKAT E KOMUNIKACIONIT	3	3	3	3	3	3	3	0.5	1
	15. ENERGJIA	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	21. RRJETET TRANS-EUROPIANE	4	4	4	4	4	4	4	0.5	1
	27. MJEDISI JETËSOR	3	2	2	2	2	2	2	0.5	2
5. BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI	11. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL	3	3	3	3	3	3	3	1	2
	12. SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE	2	2	4	4	4	4	4	2	2
	13. PESHKIMI	3	3	3	3	3	3	3	0	1
	22. POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE	3	3	3	3	3	3	3	0.5	0
	33. DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1
6. MARRËDHËNIET E JASHTME	30. MARRËDHËNIET E JASHTME	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	31. POLITIKA E JASHTME, SIGURISË DHE MBROJTJES	3	3	3	3	3	3	4	1	4

4 Janë treguar sferat dhe zonat për të cilat Raporti siguron nota uniforme që mund të përcaktohen.

Rishikimi i notave për gatishmëri:

ASSESSMENT	NUMERICAL VALUE/VLERA NUMERIKE	NOTA
AT AN EARLY STAGE	1	NË FAZË TË HERSHME
SOME LEVEL OF PREPARATION	2	MESATARISHT I GATSHËM
MODERATELY PREPARED	3	MESATARISHT I GATSHËM
GOOD LEVEL OF PREPARATION	4	NIVEL I MIRË I GATISHMËRISË
WELL ADVANCED	5	GATISHMËRI SOLIDE

Vlerësim i notave për përparim:

ASSESSMENT	NUMERICAL VALUE/VLERA NUMERIKE	NOTA
BACKSLIDING	(-4)-(-1)	KTHIM MBRAPA
NO PROGRESS	0	NUK KA PËRPARIM
LIMITED PROGRESS	1	PËRPARIM I LIMITUAR
SOME PROGRESS	2	NIVEL I CAKTUAR I PËRPARIMIT
GOOD PROGRESS	3	PËRPARIM I MIRË
VERY GOOD PROGRESS	4	PËRPARIM SHUMË I MIRË